

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË SHOQËRISË
UK-PEQIN SH.A**

NR. 02 DATË 27/04/2023

Sot, më datë 27/04 2023, Shoqëria UK-Peqin, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT K7823108J, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Nazmi Toli, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Shkarkimin e Administratorit
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria UK-Peqin nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 4351 Rep. dhe Nr. 2344 Kol, datë 14.10.2022 midis shoqërisë UK-Peqin dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivitet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 1.1.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Emërimin e Z. Megi Arapi si likuidator të shoqërisë.
- (4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u sigurua se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

KRYETAR

Lorenc TOSKU

